



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 170, datë 21.12.2012

PËR
MIRATIMIN E PROSPEKTIT TË BANKËS CREDINS PËR EMETIMIN E
OBLIGACIONEVE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/a, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenit 30, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e prospektit të emetuesit, shoqëria “Banka Credins” sh.a., për ofertën private të emetimit të obligacioneve afatgjatë me normë interesi fikse, të muajit dhjetor 2012 për shumën 1,500,000 euro, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI